

Fletë udhëzuese për ligjin për ndihmën e viktimave (OHG)

Telefoni për ndihmë i grave (Frauen Nottelefon Winterthur)

Orari i punës:

E hënë, e martë, e enjte dhe e premte: ora 10.00 - 17.00

E mërkurë: ora 13.00 - 17.00

Kjo fletë udhëzuese i drejtohet grave, të cilat kanë përjetuar dhunë fizike, psikike dhe/ose seksuale dhe janë bërë viktimë në kuptimin e ligjit për ndihmën e viktimave (OHG).

Ju keni të drejtën e ndihmes për viktimë, nëse jeni viktimë e krimit trupor, seksual dhe keni pasojë psikike.

Te drejtën e ndihmes për viktimën e kanë edhe të afërmit, fëmijët e juaj si dhe personat e afert me ju.

Oferta jonë

Shoqërim dhe përkrahje në situatën tuaj të rëndë:

- këshillim për pyetjet ligjore, sociale dhe psikologjike
- në bazë të nevojës, shoqërim tek marrja për pyetje në polici dhe prokurori
- Lidhje me avokatët, mjekët, terapeutët
- krijim i kontakteve për oferta të mëtejshme për mbështetje, institucione dhe zyra
- përkrahje në përgatitjen e kërkesës për ndihmën e viktimave

Të drejta të përgjithshme

- Si grua e prekur mund të zgjidhni nga cila këshillimore e aprovuar nga kantoni për ndihmën e viktimave doni të pranoni përkrahje. Ju e gëzoni të drejtën për këshilla juridike, sociale dhe psikologjike.
- Shërbimet e këshillimorës janë falas. Këshilltarët i nënshtrohen ligjit të mbajtjes së sekretit. Marrja e përkrahjes nuk varët nga një padi penale.
- Në mvarësi të anës financiare, ndihma për viktimat mund të **financojë shërbimet e ndihmës nga të tretët** (p.sh. shpenzimet për terapitë, strehë emergjence etj.).
- Në kushte të caktuara keni mundësi brenda 5 vitëve pas veprimit të fundit penal ose me se largu 1 vit pas vendimit të plotëfuqishëm gjyqësor të bëni kërkesë për zhdëmtim financiar (p.sh. për mungesën e të ardhurave) si dhe për **dëmshpërblim**. Ky afat vlen për vepra penale, që janë bërë mbas 1.1.2007.

Në rastin e një procesi penal ju gëzoni të drejtën:

- Për marrje në pyetje te policia dhe prokuroria, të jeni e shoqëruar nga një person i besuar
- të kërkonti, marrja në pyetje të bëhet në mungesën e të pandehurit
- të kërkonti, të lajmëroheni mbi vendimet e rëndësishme, si p.sh. lirimi nga burgu, pezullimi i ndalimit të kontaktit etj.

Nëse keni përjetuar dhunë seksuale, ju gëzoni të drejtën shtesë:

- të kërkonti, marrja në pyetje të zhvillohet nga një femër
- përkthimi i nevojshëm të bëhet nga një femër nëse nuk vonohet procedura
- të kërkonti, mos ballafaqimin me të pandehurin gjatë gjithë procesit penal
- të refuzoni deklaratat dhe përgjigjet e pyetjeve mbi sferën intime
- të kërkonti, që procesi gjyqësor të zhvillohet me dyer të mbyllura (pa publik), nëse mund të tregoni interesa për tu mbrojtur.